# DËSHMI ARKIVI

**A-467594**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rikthimi i penaliteteve, bizneset nuk po fitojnë, apo nuk po paguajnë; Të ardhurat bien 5% |
| ADRESA | `https://dosja.al/ekonomi/rikthimi-i-penaliteteve-bizneset-nuk-po-fitojne-apo-nuk-po-paguajne-te-a-i515930` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 05:49:15 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 05:39:25 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `43b91d4ad2deed5d5bce3eb1fde38566098c8b19b8d368e33ea1362972c7b054` |
| TEKSTI | `8f6750d3ff2a42fd5dc6cba77f601b019e71d83bec69da691a6df6f0c2139861` |
| PAMJA | `6aef223d86bc30b7a3242c954902466f60ceb0d8b1efe96cd9a9c6c156a070b7` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5d2104306cdd2169ba559f3997d163ff3a2eedc75f06c92f552c2d3b0e0b7a11` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `b78e5a58bb99b6139c75653f203f708926b237e838138b6b7709d24a7b49499b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5d2104306cdd2169ba559f3997d163ff3a2eedc75f06c92f552c2d3b0e0b7a11`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LIVE UPDATES ↘

8 ORE ME PARE
Tensione dhe braktisje salle në OKB/ Netanyahu sulmon Turqinë e Katarin, paralajmëron rënien e regjimit iranian. Mamdani: Përdori fjalimin e tij për të përsëritur gënjeshtra të pabaza

13 ORE ME PARE
Dita e 117-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

16 ORE ME PARE
Vlora Hyseni sulmon Klodiana Lalën para GJKKO-së, gazetarja: Shantazh. AGSH: Të tërheqë deklaratat (REAGIMET)

16 ORE ME PARE
Skandali SHISH/ Vlora Hyseni vë në rrezik vendin për Ergys Agasin: Të gjithë radarët e shtetit i mbyll për ty

Ekonomi

# Rikthimi i penaliteteve, bizneset nuk po fitojnë, apo nuk po paguajnë; Të ardhurat bien 5%

Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, nga ky zë u mblodhën në buxhetin e shtetit 38.6 miliardë lekë, me një rënie prej 5% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky është niveli më i ulët që nga viti 2022.

dosja 25 Shtator 2026, 07:39
Nga E. D



foto ilustruese

**TIRANË-** Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin janë zëri me ecurinë më të dobët në buxhetin e shtetit në tetë muajt e parë të vitit. Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave, nga ky zë u mblodhën në buxhetin e shtetit 38.6 miliardë lekë, me një rënie prej 5% në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky është niveli më i ulët që nga viti 2022.

Ecuria është në kontrast me zërat e tjerë të të ardhurave tatimore, që po shënojnë rritje të fortë. Për të njëjtën periudhë, të ardhurat nga TVSH u rritën me 10.3%, ato nga sigurimet shoqërore e shëndetësore me 13.4%, nga tatimi mbi të ardhurat personale me 13.4%.

***A po fitojnë bizneset më pak, apo nuk po paguajnë?*** Drejtoria e tatimeve i qëndron argumentit që bizneset po shtynë pagesat e tatim fitimit. Për këtë arsye, drejtori i përgjithshëm i tatimeve konfirmoi së fundmi në Komisionin e Nismave Qytetare se Ministria e Financave parashikon që në paketën e ardhshme fiskale të rikthejë penalitetin për pagesën e kësteve të tatim fitimit.

Më herët, tatimet kishin sqaruar për Monitor se ky rishikim lidhet me faktin se është konstatuar një rënie e të ardhurave nga tatim fitimi, që nuk vlerësohet se është në lidhje me situatën reale të bizneseve, duke gjykuar nga ecuria e shitjeve dhe të ardhurave nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

Nga 1 janari 2023, bizneset nuk paguajnë penalitet 10% për mospagimin në afat të kësteve tremujore të tatim fitimit, një masë që u mor kjo si një lehtësi për bizneset.

Në vend të kësaj, ligji aktual i procedurave tatimore "Mospagimi në afat i kësteve paraprake të tatimit mbi fitimin korporativ dhe tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi dhe vetëpunësimi parashikon një gjobë në masën

editoriale

Eriseld Zeneli
Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën

Irena Beqiraj
Kostot e jetesës edhe lajmi se ekonomia po ecën mirë

Në vëmendje

BOTA 24 SHTATOR 2026, 22:20
VIDEO/ Netanyahu ironizon delegatët që braktisën sallën gjatë fjalimit në OKB: Ikni frikacakë!

AKTUALITET 24 SHTATOR 2026, 21:50
Sulmi i Hysenit ndaj gazetares/ Lala: Zgjodhi njeriun e gabuar, nuk kam asgjë për të fshehur opinionit shqiptar

0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë kalendarike.

Heqja e penalitetit prej 10% për tatim fitimin duket se ka nxitur subjektet që të mos nxitojnë të paguajnë këstet e këtij detyrimi dhe të ruajnë likuiditetet.

Ndonëse biznesi do të detyrohet të paguajë tatim fitimin në fund të vitit, shuma e lartë vjetore mund ta vërë atë nën presion që të tentojë të gjejë forma për të paguar sa më pak.

Z.Binaj tha në Komision se në paktën e re fiskale synohet që të merret parapagimi në kohën që ai duhet të paguhet dhe mos të pritet një vit, pasi në momentin që mbyllet viti mundet që biznesi të ketë probleme me likuiditetin dhe nëse e paguan çdo muaj është shpesh më e thjeshtë, ndërkohë që kur mblidhet i tëri në fund bëhet akoma më e vështirë.

Bizneset ankohen vazhdimisht se kostot e aktivitetit të tyre janë shtuar, sidomos pagat e punonjësve, për shkak të rritjes së pagës minimale e maksimale, por edhe presionit të ikjes së fuqisë punëtore në emigracion.

Ky i fundit ndërkohë po ndikon dhe konsumin e brendshëm, që amortizohet në një farë mase nga shtimi i turistëve në vend. Edhe konkurrenca nga importi po dëmton prodhuesit vendas, që janë dhe punëdhënësit e tretë më të mëdhenj, pas tregtisë së shërbimeve.

Të dhënat e Ministrisë së Financave tregojnë se në vitin 2025, psh, kur sërish nuk kishte penalitete për parapagimin e tatim fitimit, të ardhurat nga ky zë u rritën me 3.5%.

Sipas ligjit për tatim fitimin, tatimi mbi fitimin parapaguhet gjatë vitit me këste mujore ose tremujore, të përcaktuara nga administrata tatimore mbi bazën e tatimit të paguar në vitet e mëparshme.

Për muajt janar–mars, kësti llogaritet mbi tatimin e dy viteve më parë, ndërsa për prill–dhjetor mbi tatimin e vitit paraardhës, zakonisht i pjesëtuar në 12 këste mujore.

Pas mbylljes së vitit, subjekti dorëzon deklaratën vjetore deri më 31 mars të vitit pasardhës. Nëse tatimi përfundimtar rezulton më i lartë se parapagimet, paguhet diferenca; nëse rezulton më i ulët, teprica mund të kompensohet me detyrime të tjera ose të përdoret për detyrime të ardhshme.

Nëse biznesi parashikon një fitim dukshëm më të ulët se një vit më parë, mund të kërkojë edhe uljen e kësteve paraprake./MONITOR

AKTUALITET 24 SHTATOR 2026, 21:04

"Poseidon" SHPK eksporton açuge me nivele shumë të larta histamine, Italia i heq nga tregu

## më të klikuarat

Atentati ndaj vëllait të Fabio Dushkut/ Aksioni i policisë greke, arrestohen 3 shqiptarë dhe shpallet në kërkim Daniel Dushku

"Krejt radarët e shtetit i mbyll për ty"/ Deklarata të forta dashurie nga Vlora Hyseni për Ergys Agasin: Të du!

Shkoi në GJKKO për tu njohur me masën e sigurisë/ Momenti kur ish-drejtuesja e SHISH i kthehet gazetares: Si kalon ti me agjentët serbë në hotel (VIDEO)

Dosja e SPAK/ Agasi mori të dhëna në telefonat e "zbërthyer" nga policia! Iu vunë në dispozicion nga përgjegjësi i Sektorit në Policinë Shkencore

## insights

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama
Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari
Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

## Sondazh

Poll

## Moti

Powered by tomorrow.io

Ekonomi

25 Shtator 2026, 07:37

Shqetësimet e bankave, rritet perceptimi i rrezikut nga tregu i pronave dhe ai politik

TIRANË- Rezultatet e vrojtimit mbi perceptimin e rreziqeve sistemike në vend nga sektori bankar tregojnë se, gjatë gjysmës së pa...

---

### Paratë në bankë kanë ende gjini; Gratë vetëm 44% e depozituesve

Ekonomi

25 Shtator 2026, 07:34

---

### Bizneset po kërkojnë dhe po marrin më shumë kredi

Ekonomi

25 Shtator 2026, 07:29

---

### Në Shqipëri burrat dominojnë gratë edhe në depozitat bankare

Ekonomi

24 Shtator 2026, 17:00

---

### Kodi Doganor ndryshon, lehtësohen sanksionet për bizneset

Ekonomi

22 Shtator 2026, 08:49

---

Ekonomi

22 Shtator 2026, 08:46

## Punësimi sezonal jashtë solli një rekord të ri historik prej gati 400 mln euro në janar-qershor

Foto Ilustruese TIRANË- Të ardhurat e ekonomisë shqiptare nga puna jashtë vendit po rriten për të gjashtin vit radhazi dhe ka...

---

### Gati projektligji, kufiri i sigurimit të depozitave rritet në 6 milionë lekë, nga

2.5 aktualisht

Ekonomi

22 Shtator 2026, 08:43

---

### Hetimet dhe sekuestrimit e SPAK ulin kërkesën për apartamente, kush po blinte?!

Ekonomi

22 Shtator 2026, 08:42

---

### Vera 2026 rriti numrin e turistëve, por shtoi pikëpyetjet

Ekonomi

20 Shtator 2026, 07:20

---

### Kartëmonedhat e reja Euro, qytetarët pjesë e vendimmarrjes

Ekonomi

19 Shtator 2026, 08:13

**MË SHUMË**






Mbyllen fjalimet para Kryeministrisë, qytetarët marshojnë në rrugët e kryeqytetit...



Aktivisti Lika për Vlora Hysenin: Nuk duhej të futej në SPAK, duhet të jetë në burg



Aktivisti Arben Kola thirrje shqiptarëve në SHBA: Priteni Ramën me vezë para OKB-së...



Aktivistja Vatnikaj: Dejtoresha e SHISH i jepte informacione Agasit për t'i shpëtuar policisë

## Mbyllen fjalimet para Kryeministrisë, qytetarët marshojnë në rrugët e kryeqytetit...

Shiko video te tjera



Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të



Drejtor: Enton Abilekaj
Kryeredaktor: Izmir Akulli
Gazetarë:

interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [email protected]



Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni



MUNDESUAR NGA Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.